

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Reforma Territoriale, Këshilli Bashkiak i Krujës voton kundër kalimit të Rinasit dhe aeroportit “Nënë Terez a” nën administrimin e Tiranës
ADRESA	https://prapaskena.com/2026/09/18/reforma-territoriale-keshilli-bashkiak-i-krujes-voton-kunder-kalimit-te-rinasit-dhe-aeroportit-nene-tereza-nen-administrimin-e-tiranes/
BURIMI	prapaskena.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 12:31:04 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	17 shtator 2026, 22:00:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 17 shtator 2026, 21:59:00 UTC → 17 shtator 2026, 22:01:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund t ë gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	9f4968904a1e4c38bcc41394d193d90d573d706ceecca370c47fcd37484e289
TEKSTI	b287957c6e951a39068c8f24cd4b7d9611e73ba402e69e1b1e0cc7c38112ded6
PAMJA	b2097dbd5c29e6e79054e679afab2fd94f89a04e4905f2e9724e357c514e9a60

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	4aaa0b6b98f71254cd26934f5faa8aa3cbea59243874466c3490309a98c3d7e8
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	c2d3424a52af1d7a5bda261c525771941165d93d82c499297c4e9de151b879e4
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te bllok, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/4aaa0b6b98f71254cd26934f5faa8aa3cbea59243874466c3490309a98c3d7e8>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

R

eforma Territoriale, Këshilli Bashkiak i Krujës voton kundër kalimit të Rinasit dhe aeroportit “Nënë Tereza” nën administrimin e Tiranës

Politikë

Publikuar: 18/09/2026



Këshilli Bashkiak i Krujës ka kundërshtuar unanimisht propozimin për shpërbërjen e Rinasit dhe territorit ku ndodhet Aeroporti Ndërkombëtar “Nënë Tereza” nga Bashkia Krujë dhe kalimin e tyre në administrimin e Bashkisë Tiranë.

Të 31 këshilltarët bashkiakë votuan kundër propozimit të Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Administrativo-Territoriale, i cili parashikon ndryshimin e përkatësisë administrative të Rinasit.

Sipas propozimit, zona do të shpërbëhet nga Njësia Administrative Nikël, pjesë e Bashkisë Krujë, për t’u bashkuar Bashkisë Tiranë.

Në argumentet e paraqitura, Këshilli Bashkiak i Krujës thekson se ndryshimi i propozuar nuk duhet parë vetëm si një riorganizim administrativ, por si një ndërhyrje në territorin dhe kufijtë e Bashkisë Krujë dhe të Qarkut Durrës.

Për këtë arsye, këshilltarët kërkojnë që çdo vendimarrje të paraprihet nga transparencë dhe konsultim real me komunitetin e prekur, në përputhje me Kushtetutën, Kartën Europiane të Autonomisë Vendore dhe legjislacionin në fuqi.

Sipas Këshillit, Rinasi nuk përfaqëson vetëm territorin ku është ndërtuar aeroporti, por është një zonë ku jetojnë familje, ku ndodhen prona, toka bujqësore dhe biznese.

Këshilli argumenton se banorët e kësaj zone kanë lidhje historike, gjeografike dhe komunitare me Niklën dhe Bashkinë Krujë.

Këshilli Bashkiak shton se kundërshtimi ndaj ndryshimit të

Me të lexuarat

Kush është

Behajdin Allaqi, njeriu që Haga vendosi në qendër të dënimit të



Thaçit dhe rrethit të rrethit dhe rrethit...




pornografike në një bisedë me shoqet, si u zbulua abuzimi



Fazlajtari me naftë/

Shehu kërkon llogari për gjenocidin serb, Haga



Rinasit, kështu që

Edvin Bozhaj kapet duke vjedhur paratë publike në bashkëpunim



me rrethit e rrethit...

Shehaj skemë korrupsioni me burrin avokat që u shkarkua nga Vetingu me

kërkesë...

kufijve nuk lidhet me zhvillimin e Rinasit apo të Aeroportit “Nënë Tereza”.

Përkundrazi, sipas tij, Bashkia Krujë mbështet investimet dhe projektet që sjellin zhvillim ekonomik, infrastrukturor dhe social për zonën.

Argumenti i këshilltarëve është se zhvillimi i Rinasit dhe aeroportit nuk kushtëzohet domosdoshmërisht nga ndryshimi i përkatësisë territoriale.

Një tjetër pikë e ngritur nga Këshilli Bashkiak është ndikimi ekonomik i aeroportit në buxhetin vendor.

Sipas tij, Bashkia Krujë përfiton aktualisht rreth 10% të të ardhurave të lidhura me aktivitetin e aeroportit, që përkthehen në rreth 40 milionë lekë.

Këto të ardhura konsiderohen të rëndësishme për financat e pushtetit vendor dhe për investimet në territor.

Në vend të ndryshimit të kufijve, Këshilli kërkon forcimin e Bashkisë Krujë përmes investimeve infrastrukturore.

Mes prioriteteve të renditura janë ndërtimi i rrugës Krujë-Tiranë, rikonstruksioni i aksit Krujë-Fushë-Krujë, ndërtimi i Unazës Jugore të Fushë-Krujës, si dhe zgjidhja e problematikave të hyrje-daljeve që lidhin Bashkinë Krujë me aksin Thumanë-Kashar.

Këshilli Bashkiak e konsideron çështjen me karakter territorial, institucional dhe interes publik, duke kërkuar që përpara çdo vendimmarrjeje përfundimtare të zhvillohet një proces transparent konsultimi me banorët dhe komunitetin e Rinasit.

TAG:

Reforma territoriale

Të ngjashme



Presidenti Begaj dekreton ligjin për formulën e re të pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve!



“A t’u martua daja?”/ Gallatë në orët e vona në Kuvend, Zegjine Caushi përplaset me Bardhin: Shiko hallin tënd, Gazo!



Sali Berisha pranon se ka paguar para për të marrë një vizë amerikane, ja kush lloboi

Prapaskena

‘Prapaskena’ lindi si një nismë e një grupi gazetarësh me përvojë dhe plotësisht të

Copyrights

Çdo kopjim, përdorim apo riprodhim i paautorizuar i këtij materiali është i ndaluar

Kategoritë

KREU INVESTIGIM

pavarur nga çdo parti politike, grup interesash apo klane biznesi, me qëllim për të thënë çdo të vërtetë të guximshme me interes publik. 'Prapaskena' është një media e lirë dhe e pakompromis, e cila ka si qëllim informimin e opinionit publik në mënyrë të paanshme, profesionale dhe në dritën e të vërtetës, mbi çështje që lidhen me korrupsionin politik, krimin, pandëshkueshmërinë, grabitjen e pasurive publike, mbi reformat, sfidat kombëtare dhe lidhjet e padukshme mes partive politike, mediave të njësua me interesat klienteliste, krimin dhe biznesit jo të ndershëm, të cilët në bashkëpunim përvetësojnë paratë dhe pasuritë publike.'

dhe mund të sjellë ndjekje ligjore. Ju lutemi respektoni punën dhe përpjekjen tonë duke mos e shkelur këtë parim.

[KRIM & KORRUPSION](#) [DOSJE ROZE](#)

[KRYESORE](#) [POLITIKË](#) [EKONOMI](#)

[ANALIZË](#) [RAJON](#) [KULTURË](#) [SPORT](#)



Email: [\[email protected\]](#)

Copyright © 2025. All Rights Reserved by Prapaskena

[Privacy Policy](#) | [Cookies](#)

Notice: ob_end_flush(): Failed to send buffer of zlib output compression (1) in /home/prapaskena/public_html/wp-includes/functions.php on line 5581 Notice: ob_end_flush(): Failed to send buffer of zlib output compression (1) in /home/prapaskena/public_html/wp-includes/functions.php on line 5581 Notice: ob_end_flush(): Failed to send buffer of zlib output compression (1) in /home/prapaskena/public_html/wp-includes/functions.php on line 5581 Notice: ob_end_flush(): Failed to send buffer of zlib output compression (1) in /home/prapaskena/public_html/wp-includes/functions.php on line 5581

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.